



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

PROGRAM ORIENTUES PËR MATURËN SHTETËRORE

LËNDA:

GJUHË GJERMANE

PROVIM ME ZGJEDHJE (Niveli B2)

Koordinatore: Erifili Hashorva

Viti shkollor 2014 – 2015

**Tiranë
Janar, 2015**

1. UDHËZUES I PËRGJITHSHËM MBI PROGRAMIN E PROVIMIT KOMBËTAR TË MATURËS SHTETËRORE PËR LËNDËN E GJUHËS GJERMANE DHE MBI PËRDORIMIN E TIJ NGA MËSUESIT

Hartimi i këtij programi orientues është bazuar tërësisht në programet e gjuhës gjermane, të cilat përcaktojnë njohuritë dhe shprehitë e domosdoshme gjuhësore, komunikuese dhe funksionale.

Programi orientues për përgatitjen dhe realizimin e provimit të Maturës Shtetërore për gjuhën gjermane si lëndë me zgjedhje, është realizuar si sintezë e njohurive dhe shprehive të fituara gjatë gjithë procesit mësimor në këtë lëndë, si në aspektin tematik ashtu edhe në aspektin gjuhësor (gramatikor, leksikor) dhe funksional.

Niveli i njohurive i përket nivelist **B2** sipas dokumentit evropian “Kuadri i Përbashkët Evropian i referencave për Gjuhët.

Hartimi i këtij programi orientues është bazuar tërësisht në kurrikulat e gjuhës gjermane për shkollën e mesme, duke pasur parasysh zhvillimin e aftësive gjuhësore që do të testohen, standarde e gjuhëve të huaja, tekstet me të cilat është zhvilluar gjuha gjermane në shkollën e mesme si edhe përvojën e fituar nga provimet e maturës shtetërore të viteve pararendëse. Ky program duhet t'i inspirojë të gjithë nxënësit duke përbërë një sfidë për ta dhe t'i përgatisë për të ardhmen e tyre. Ky Program Orientues për provimin e Maturës Shtetërore për Gjuhën gjermane, është ndërtuar duke pasur parasysh nevojat e nxënësve dhe zhvillimet e tyre personale.

Synimet e Programit

Ky program synon:

- Të ndihmojë nxënësin në përgatitjen e tij për provimin e maturës në gjuhën gjermane.
- Të ndihmojë mësuesin e lëndës në punën e tij për zbatimin e programit dhe për t'u dhënë orientimet e duhura nxënësve.
- Vlerësimin e njëkohshëm të 2 aftësive kryesore (nga katër aftësi që ka gjuha e huaj) dhe dy konceptet bazë, që janë: **të lexuarit dhe të kuptuarit** dhe **të shprehurit me shkrim**.
- Të japë orientime për specialistët e gjuhës gjermane që merren me hartimin e testeve të Maturës Shtetërore.

- Vlerësimin e të kuptuarit dhe të shprehurit me anë të strukturave gjuhësore bazë, aftësinë për të përdorur gjuhën që është e përshtatshme për gjermanishten standarde (në aspektin e saj morfologjik, sintaksor, leksikor dhe funksional).
- Të matë aftësinë për të përdorur formimin gjuhësor në mënyrë të pavarur, në mënyrë korekte dhe të përshtatshme në situatën e komunikimit me shkrim duke shprehur aftësinë e organizimit të ideve, mbrojtjes së ideve të tyre me shembuj dhe argumente nga jeta e tyre.

Udhëzime praktike mbi përdorimin e programit

Për përdorimin e këtij programi mësuesi duhet të ketë parasysh specifikën e gjuhës së huaj, ku nxënësi në provim do të përballet me situata të reja ose me pjesë të reja leximi por tematika, gramatika dhe funksionet gjuhësore do të janë po ato.

Kur flitet për tematikën kryesore në program, kjo nuk do të thotë që në provim do të ketë pasazhe nga mësimet që ka në libër. Në provim mund të dalë jeta e një figure të shquar në fusha të ndryshme jo ajo e cila pasqyrohet në tekstin mësimor. Kështu që mësuesi duhet t'i përgatisë nxënësit që të kenë njohuri dhe një bagazh të konsiderueshëm leksikor për temat që janë te përfshira në program.

Pjesë e testimit do të jetë gramatika, këtu mësuesi duhet të përgatisë nxënësit që të janë në gjendje të zgjidhin ushtrime mbi një problem të caktuar gramatikor (Präpositionen, Passiv, Perfekt, Präteritum, Modalverben, Konjunktiv II, u.s.w.), duke dalë nga tipi i ushtrimeve tradicionale që jepen nëpër tekste dhe duke praktikuar formate të reja ushtrimesh ku të përfshihen këto aspekte gramatikote, duke e parapërgatitur nxënësin për ato çka do trajtohen në provimin me zgjedhje të Maturës Shtetërore. Mësuesi duhet të fokusohet në anën praktike të zgjidhjes së ushtrimeve, duke i trajtuar këto ushtrime në forma të ndryshme, herë me tipe ushtrimesh me alternativa, e herë tipe ushtrimesh të hapura, etj.

Funksionet gjuhësore duhet të trajtohen në mënyrë sa më të larmishme duke përdorur situata nga të gjitha fushat e jetës por duke ruajtur formatet dhe shprehjet që jepen në tekstet mësimore.

Përsa i përket të shkruarit mësuesi duhet të ushtrojë nxënësit e tij që të dinë të organizojnë me të tëra elementët forma të ndryshme eseje ose kompozimi jo letrar. Ata duhet të përgatiten që të ndërtojnë paragrafë të saktë nga ana strukturore dhe leksikore, dhe paragrafët në një njësi të unifikuar (ese` ose thjesht kompozim). Gjithashtu mësuesi duhet të përgatisë nxënësit që të

jenë të aftë të përbledhin me shkrim një përvojë personale duke përshkruar ndjenjet dhe reagimet e tij në një tekst koherent.

2. Aftësitë dhe njohuritë që duhet të zoterojë nxënësi maturant për të qenë i përgatitur për Provimin e Maturës në Gjuhën gjermane.

Nxënësi i ushtrohet provimit të Maturës në Gjuhën gjermane duhet të demonstrojë **aftësitë dhe njohuritë** e tij si më poshtë vijon:

2.1 Të kuptuarit me shkrim –Leseverstehen

Vlerësimi i këtij komponenti do të bëhet mbi bazën e një teksti të panjohur mbi të cilin do të ndërtohen pyetje që do të testojnë aftësinë e nxënësit për të kuptuar një pjesë letrare ose jo letrare, dhe për të gjykuar mbi të.

Nxënësi duhet të jetë në gjendje të lexojë dhe të kuptojë në mënyrë globale tekste për të gjetur informacionin e kërkuar; për të mbledhur informacionet që i kerkohen nga pjesë të ndryshme të një teksti, apo tekste të ndryshme për të përbushur një detyrë apo kérkesë të caktuar.

Më poshtë po radhisim disa aspekte të leximit:

- Marrja dhe përzgjedhja e informacionit të duhur nga teksti i dhënë.
- Reflektimi mbi përbajtjen e një fragmenti dhe nxjerra e informacionit të duhur prej tij.
- Paraqitura e elementeve provues që mbështesin idenë e dhënë nga vetë nxënësi.
- Thellim në kuptimin e një fraze dhe gjetja e sinonimit të saj.
- Formimi i një kuptimi të përgjithshëm dhe nxjerra e moralit të pjesës.
- Zhvillimi i aftësisë krijuese dhe interpretuese dhe paraqitura e elementeve që justifikojnë përgjigjen e dhënë.
- Kuptimin global të tekstit.
- Kuptimi i thelluar: gjetja e të pashprehurës ose idesë që nënkuftohet, qëndrimin e autorit, etj.
- Plotësimi i ushtrimeve leksikore rreth tekstit.
- Gjetjen e fjalëve referuese.

- Zgjidhjen e ushtrimeve leksikore dhe gramatikore rrreth tekstit.

2.2 Të shprehurit me shkrim

Në provimin e maturës nxënësi duhet të jetë në gjendje të prodhojë tekste të shkruara mbi një gamë të gjerë temash duke i lidhur elementët në mënyrë lineare, duhet të jetë në gjendje të bëjë përshkrime të hollësishme mbi tema të njoitura, të tregojë me shkrim përvojat e tij duke përshkruar ndjenjat dhe reagimet e tij, të përshkruajë një ngjarje, një udhëtim real apo imagjinar, të tregojë një histori, të shkruajë ese' mbi tema të ndryshme, të shkruajë një letër personale apo zyrtare, të bëjë komentin e një filmi qartë, të shkruajë një informacion duke u nisur nga shënimet e marra etj.

Për vlerësimin e kësaj aftësie nxënësi duhet të paraqesë një produkt të shkruar prej **120-150 fjalësh**, në të cilin duhet të zhvillojë një temë mbi një çështje me interes të përgjithshëm e duke marrë shkas nga pjesa e panjohur ose që nuk ka lidhje me të. Nxënësi do të vlerësohet përfshin: përbajtjen, leksikun, korrektësinë gramatikore dhe strukturën e koherencën.

Të shprehurit me shkrim përfshin:

- të shprehurit me shkrim në formën e një eseje për një gamë të gjerë temash të njoitura e komplekse që janë trajtuar në librat e tre viteve.
- një produkt të shkruar saktë nga ana gramatikore dhe të strukturuar mirë;
- lidhjen në mënyrë koherente të informacioneve nga burime të ndryshme;
- shprehjen e pikëpamjeve në formë të argumentuar;
- përdorimin e një repertori të gjerë leksikor;
- komente me shkrim për probleme të ndryshme.

2.3- Përdorimi i Gjuhës

Në këtë program njoiturë kryesore që nxënësi ka marrë në shkollën e mesme, janë të dhëna përmes **fushës tematike** të mëposhtme, e cila është e ndarë në linja dhe nën-linja sipas tematikës së zhvilluar dhe **elementëve gramatikorë**, të cilët zhvillohen në mënyrë spirale nga viti në vit dhe jepen të detajuara në program.

d) Shprehitë

Shprehitë kryesore që nxënësi ka fituar janë dhënë përmes **akteve dhe funksioneve komunikative**. Ato tregojnë se cilat janë shprehitë kryesore që një nxënës ka fituar përmes realizimit të programit dhe që ai është i aftë të shprehë.

Tipet e ushtrimeve të rekondituara për çdo fushë

Të kuptuarit me shkrim (Leseverstehen)
<ul style="list-style-type: none"> - pyetje mbi përbajtjen e tekstit - ushtrime me vende bosh - ushtrime me përgjigje po/jo - ushtrime të tipit e vërtetë/e rreme - ushtrime me disa alternative - renditja e paragrafeve të ngaterruar sipas logjikës dhe koherencës - gjetja e një informacioni në një tekst - gjetja e një informacioni nga tekste të ndryshme
Leksiku dhe gramatika (Wortschatz und Grammatik)
<ul style="list-style-type: none"> - ushtrime me zëvendësim - ushtrime transformimi - ushtrime me alternative - ushtrime me plotësime vendesh bosh - ushtrime ndërtim fjalish - ushtrime bashkim fjalësh me kuptimin, gjetje gabimesh - bashkim funksioni me strukturën përkatëse - gjetja e sinonimeve/antonimeve - shprehja e të njejtit kuptim me fjalë të tjera
Të shkruarit (Schriftlicher Ausdruck)
<ul style="list-style-type: none"> - të shprehurit në formë dialogu - formulim pyetje/përgjigje - plotësim frazash - letër formale dhe joformale, mesazh, e-mail, kartolina, ftesa, njoftime, aplikime - rrashitje paragrafesh sipas koherencës - hartim me pika referimi - përbledhje, koment - ese' e shkurtër

- plotësim i një formulari

Struktura e Provimit në përqindje

Struktura e Provimit në përqindje	Përqindja
Të kuptuarit me shkrim (Leseverstehen)	40%
Leksiku dhe gramatika (Wortschatz und Grammatik)	40%
Të shprehurit me shkrim (schriftlicher Ausdruck)	20%

3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Fushat tematike dhe leksiku

Përbajtja tematike është mbështetur në programin dhe tekstet shkollore për gjuhën gjermane. Tematika e mëposhtme, e parashikuar për provimin e maturës, do të përfshijë temat bazë (sipas kurrikulës) dhe nëntema të marra nga kurrikula dhe tekstet.

Temat janë formuluar në mënyrë përgjithsuese e jo sipas titujve të teksteve dhe përfshijnë ato njohuri të cilat janë zhvilluar përmes mësimeve.

Erlebnisbereich “Ich als Person”

- Persönliche Daten, (Lebenslauf)
- Aussehen und Geschmack
- Körper und Gesundheit
- Bekleidung
- Tagesablauf
- Freizeit und Hobbys
- Zukunft
- Abenteuer

Erlebnisbereich “ Unmittelbare Umgebung”

- Familie, Freunde und Bekannte, Nachbarn
- Familie, Familienaufgaben - Rollenverteilung
- Familienfeste und Geschenke
- Essen und Trinken
- Gesunder Lebenstil und Gesellschaft
- Wohnung, Umzug und Einrichtung
- Jugend und ihre Probleme
- Sport und Fitness
- Liebe und Liebeskummer
- Träume und Wünsche
- Auf dem Land /in der Stadt

Erlebnisbereich “ Weitere Umgebung”

- Fremd(e)
- Integration
- Emanzipation und Gleichberechtigung
- Reisen, Reisegefühle, Reisepläne
- Urlaub, Natur und Landschaft
- Kommunikation
- Länder, Städte, Sprachen
- Schule, Schulerfahrungen und Ausbildung
- Arbeitswelt und Karriere
- Beruf, Job und Praktikum
- Konsum und Warenwelt (Kundenwünsche)
- Mobilität
- Technik und Alltag

Vermitteltes Erlebnisbereich

- Medien und Werbung
- Nachrichten und Berichte
- Landeskunde und interkulturelles Lernen
- Das eigene Land
- Deutschsprachige Länder
- Aus der Politik und Geschichte
- Wissenschaft und Forschung
- Literatur und Kunst
- Kultur und modernes Leben

Funkzionet kommunikative

Propozohen aktet dhe funktionet e mëposhtme:

- Eigene Meinungen äussern: meiner Meinung nach...; Ich bin mir sicher dass...; Ich würde sagen ...; usw.
- Vermutungen, Behauptungen formulieren: Ich behaupte...; Ich vermute...; Ich glaube...; Kann sein dass...; Wahrscheinlich...; usw.

- Sich pro und kontra äussern: Ich stimme zu; Ich bin dafür; Ich bin völlig dagegen. usw.
- Über eigene Erfahrungen berichten. Über Ereignisse in der Vergangenheit berichten.
- Die eigene Meinung sagen und Argumente für den eigenen Standpunkt nennen
- Etwas Irreales ausdrücken.
- Ratschläge geben, um Rat bitten
- Gefallen, Missfallen ausdrücken.
- Vorschläge annehmen und ablehnen
- Gefühle ausdrücken, Wünsche äussern
- Informieren und nachfragen.
- Etwas begründen, etwas beurteilen, etwas bewerten, vergleichen, Verständnis zeigen, erstaunt oder kritisch reagieren.
- Ansichten begründen und verteidigen
- Probleme beschreiben und sich beraten lassen
- Anzeigen verfassen, auf eine Anzeige antworten und Informationen über sich geben.
- Verhalten und Reaktionen anderer beurteilen und Vermutungen über Handlungen von Personen anstellen

Elementet dhe strukturat gramatikore

Për një komunikim të saktë nga ana gramatikore, si me gojë ashtu edhe me shkrim, sugjerohet të punohet në mënyrë të përqendruar mbi strukturat dhe çështjet gramatikore më të rëndësishme të trajtuarë deri tani.

- Verb: Präsens
- Perfekt, Präteritum
- Futur1, Plusquamperfekt
- Passiv
- Passiv mit Modalverben
- Konjunktiv II
- Die Umschreibung der K. II mit würde + Infinitiv
- Regelmässige, Unregelmässige Verben
- Trennbare Verben
- Modalverben

- Partizip I und II
- Unbestimmter, bestimmter Artikel, Negativartikel, Frageartikel
- Substantiv: Singular, Plural
- Deklination des Substantivs
- Genus der Nomen
- Zusammengesetzte Nomen
- Wortbildung
- Adjektiv :Adjektivideklation und Graduierung
- Prädikativ, Attributives Adjektiv
- Adjektiv als Nomen, n- Deklination
- Verb und Ergänzungen, Akkusativ- und Dativergänzung: Stellung im Satz
- Infinitiv mit zu.., statt zu +Infinitiv,ohne zu + Infinitiv
- Präpositionen mit Akkussativ, Dativ, Genitiv, Wechselpräpositionen
- Präpositionaladverbien
- Verben mit Reflexivpronomen
- Possessivartikel
- Demonstrativartikel: dieser, dieses, diese
- Indefinitpronomen
- Nebensätze: / Kausalsätze
- Temporale Nebensätze
- Konsekutivsätze/ Finalsätze/ Konzessivsätze
- Relativsatz/ Relativpronomen
- Konditionalsatz
- Vergleichssätze
- Temporal-Kausal-Modal-Lokalangaben
- Verben mit Präpositional-Ergänzungen
- Funktionsverb-Gefüge (Nomen- Verb- Verbindungen)
- Wortbildung: Substantive aus Verben
- Aufforderung und Imperativ
- Konjunktionen
- Direktionaladverbien
- Ordinalzahlen

- Die Position der Wörter im Satz
- Satzklammer
- Zweiteilige Konnektoren
- Partikeln